



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Data _____.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: "Shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit".

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Pjesë këmbimi për automjete, furgonë dhe makina transporti mallrash-34330000-9; Pajisje të ndryshme transporti dhe pjesë këmbimi-34960000-6 ;Shërbime të transportit rrugor-60100000-9

VLERA E FONDIT LIMIT: 1 083 333 (një milion e tetëdhjetë e tre mijë e treqindë e tridhjetë e tre) lekë pa tvsh.

Argumentimi i fondit limit: Komisioni i llogaritjes fondit limit dhe specifikimeve teknike për llogaritjen e fondit limit i është referuar nenit 76 të pikës (b) të VKM-së me nr.285,datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “studimin e tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim”, çmimet i ka bazuar te studimi i tregut bazuar kjo në mesataren e çmimeve të marra nga studimi që ka kryer komisioni i llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike (KLLFLST). Nga ofertat e marra nga subjektet që operojnë në aktivitete të ngjashme me objektin e këtij prokurimi, komisioni ka vendosur çmimet në baz të mesatares së ofertave ,me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë,dokumentuar me relacionin nr.6816/2prot.datë 03.09.2024

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik” dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Roskovec ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”;;”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

Këto kritere janë vendosur për të vertetuar pjesëmarrjen ose jo të operatorit ekonomik në tendera, duke paraqitur oferte. Gjithashtu këto kritere janë vendosur edhe për të vërtetuar deklaratimet dhe dokumentat e paraqitura nga operatorët ekonomik, duke kaluar tërësisht përgjegjesinë administrative ose penale gjithashtu barrën e proves tek operatorët ekonomik për dokumentat e paraqitura.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

a. Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme, sipas shtojcës 8 dhe 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 14, pika 2, dhe 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”; nenin 39, pika 6/b, dhe nenin 88, Pika 4 të të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Ky kriter vendoset për të vërtetuar që operatori ekonomik pjesëmarrës ka eksperiencën e duhur dhe kapacitetin potencial ekonomik.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për vitet financiare 2022-2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës e përkatësisht: 400 000 lekë pa tvsh.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa

shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Per prokurimin publik"; si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke patur në konsideratë vlerën e objektit të prokurimit: "**Shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit**", pika 3 e nenit 77 të LPP i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Per prokurimin publik" dhe sipas parashikimeve në nenin 43, pika 1 dhe 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku parashikohet se: "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar..", si dhe mbi bazën e nenit 29, të ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.", si pika 1 dhe 2/c, në zbatim të nenit 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe nenit 41, gërma "c" të ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

2.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet për vitin 2023.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Per prokurimin publik"; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, si dhe sipas Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia ROSKOVEC, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila

funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 2 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.3 Kapaciteti teknik:

22.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **200 000** lekë pa tvsh.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe në nenin 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limitit të kësaj kontrate, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. **Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:** Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës shërbimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1, 3 e VKM 285/2021 i ndryshuar, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. AK argumenton se shërbimet e mëparshme të ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (pika a dhe b të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e shërbimeve publike/private të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

2.3.2 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën 3 (tre) punonjës për muajin fundit të deklaruar, të vërtetuar me:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për kete muaj.
- b) Listpagesa e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi per periudhen e mesiperme.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:

Eshte kerkuar nr. punonjesish prej 3(tre) personash duke llogaritur **personelin kryesor** per realizimin e kontratës.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.3.3- Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar **punonjës të specializuar si: 1 (një) specialist-motorist,1 (një) specialist-elektroaut,1 (një) specialist- xhenerik të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimalisht për muajin e fundit te deklaruar.**

Të vërtetuar me:

- CV të specialistit
- Dëshmi/Certifikatë kualifikimi.
- Kontrata e punës e vlefshme
- *Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, **i ndryshuar** , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.Stafi inxhinierik që do të realizojë mbikqyrjen është kërkuar në përputhje me stafin inxhinierik të nevojshëm për zbatimin e punimeve, zërat përkatës të preventivit si dhe me projektin e zbatimit të punimeve. Argumentimi: Është kërkuar ky numër

mesatar punonjësish, gjithashtu edhe periudha për të pare nëse operatorët ekonomik kanë kapacitetin e duhur për të përmbushur shërbimet e pershkruara në kontratë brenda afatit të caktuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht: Referuar natyres se shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic jane riparime dhe mirmbajtje të agregatit të motorrit, të karrocise, te sistemeve drejtimit, frenimit, kondicionimit, amortizimit etj eshte e nevojshme pasja e nje stafi teknik me profesione si motorrist, xhenerikë, elektroaut, e vertetuar kjo ne baze te kontratave te punës si dhe të deklaratës se plotësuar nga operatori ekonomik me qellim realizimin me sukses të kontrates. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit.

Kërkesa e AK që OE duhet të ketë në stafin e tij specialist motorrist, specialist elektroaut, dhe xhenerik është në funksion të realizimit të kontratës duke patur parasysh zërat përkatës të shërbimeve për secilin automjet si dhe kualifikimin e duhur profesional që duhet të kenë specialistët që do të kryejnë diagnostikimin dhe riparimin e tyre.

Referuar zërave të shërbimeve të kërkuara në preventivin e hartur nga KLLFLST për secilin automjet, duket qartazi domosdoshmëria për specilaistët e nevojshëm të cilët kanë aftësinë dhe formimin profesional, dhe që janë specializuar për t'i kryer ato.

- Numri i përcaktuar i punonjësve është për llogaritur si më poshtë:

Duke iu referuar zërave analitikë të parashikuar në specifikimet teknike për shërbimin e mirëmbajtjes së automjeteve, sqarojmë së objekti i kontratës do të jetë mirëmbajtja e 24 automjeteve të AK. Në varësi të aktivitetit që ato kryejnë, shërbimet do të kërkohen nga AK që të kryhen për secilin automjet në kohë të ndryshme dhe jo njëherësh. Kështu që OE kontraktor do të mjaftonte që të ketë të punësuar jo më pak se 3 punonjës në mënyrë që të përmbushë realizimin e shërbimit të kërkuar në çdo kohë dhe se ky numër është i domosdoshëm dhe i mjaftueshëm që të gjitha nënvojat e AK për shërbimin e mirëmbajtjes së automjeteve të përcaktuar do të bëhet në kohë dhe me cilësinë e duhur.

Për sa i përket dokumentacionit si CV apo Dëshmi/Certifikatë kualifikimi për te pare nese stafi ka eksperiencen, aftesine dha ka perputhshmeri me legjislacionin per te permbushur sa me mire punet e kerkuara sipas specifikimeve teknike.

2.3.4.Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, konkretisht:

a-OE duhet te disponoje ura ngritese dhe gropa kontrolli

b-Operatori ekonomik duhet te jete i pajisur me karrotrec ne pronesi ose me qera

Të vërtetuar me:

a-Çertifikata e pronesise se objektit (servisit te automjeteve) ose kontrata e qeramarrjes se objektit.

- b- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit:- certifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; leja e transportit e vlefshme dhe fotot përkatëse;
- c- Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- d- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- e- Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Ky kriter është vendosur me qëllim verifikimin gjendjes fizike të urave ngritese dhe dokumentacioni është kërkuar me qëllim për të vërtetuar që OE disponon ura ngritese dhe gropa kontrolli në pronësi ose me qera të operatorit ekonomik dhe me dokumenta të rregullta. AK kërkon që OE duhet të disponojë ura ngritese dhe gropa kontrolli të nevojshme në riparimin e automjeteve,

Për riparimin e automjeteve, ato detyrimisht duhet të ngrihen në urë vinç që të kryhet shërbimi i kërkuar.

Kërkesa që OE duhet të disponojë një automjet karroatrec, i cili do të jetë i nevojshëm nëse ndonjë prej automjeteve të AK gjatë aktivitetit ditor pëson ndonjë defekt të mundshëm dhe si pasojë e kësaj nuk mund të shkojë vetë pranë pikës së servisit të OE kontraktor.

Ky kriter vendoset gjithashtu me qëllim për të reduktuar kostot e transportit të mjeteve të demtuara që çohen në servis e marrjen e shërbimit në një kohë sa më të shpejt.

Si dhe nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate është riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve, ndër të cilat mund të ndodh që në raste të caktuara duhet të transportojnë një automjet të difektuar në ambientet e servisit që disponon OE, është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) automjet, konkretisht karroatrec me qëllim realizimin të objektit të prokurimit.

2.3.5-Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit për mjetet në rastet e difekteve nga adresa e autoritetit kontraktor deri në servis, si dhe të pjesëve të këmbimit.

Argumentimi: Me anë të kësaj deklarate synohet që në rast se AK-se do t'i lind nevoja për riparime të mjeteve në vende ku makineria që mund të pesoje defekt dhe mund të transportohet

vetem me karrotrec, OE do te jete i gatshem te kryeje sherbimin e transportit te automjetit ne servis.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet te kete (servisin e automjeteve), qe **duhet te jetë në një distancë jo më të largët se 25 km nga vendndodhja e objektit të prokurimit**, vertetuar kjo me nje nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontrate qiraje noteriale/ akt pronesie). *Argumentim : Ky kriter është vendosur duke u bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 5, e VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar si dhe duke marrë parasysh gjithashtu edhe mjetet e rënda teknologjike të cilat nuk mund të përshkojnë distanca të largëta rruge pra ky kriter vendoset me qëllim për ti favorizuar mjetet e rënda teknologjike si dhe mjetet e tjera të mos nevojitet të përshkojnë distanca të largëta rruge jashtë territorit të Bashkisë pasi do kemi kosto karburanti nese mjetet e bashkis do ti ofrohet shërbimi i riparimit të mjetit në një servis me distanc të largët nga Bashkia .*

2.3.7 Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet : *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”,* si dhe përcaktimet e pikës 6 të këtij neni ku parashikohet: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

*Argumentimi :*Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 26, pika 1e VKM-së, nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar .

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

U ra dakort nga antaret e Njesisë së Prokurimit të ngritur me urdher të titullarit të autoritetit kontraktor,**nr.123,datë.09.09.2024**, për këto kërkesa për kualifikim pasi kërkesat e mësipërme janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës që është: **"Shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit".**„,me fond limit prej: **1 083 333 (një milion e tetëdhjetë e tre mijë e treqindë e tridhjetë e tre) lekë pa tvsh,,E hapur e thjeshtuar.**

Ato do të shërbejnë për njohjen e plotë të gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës .

Kërkesat e veçanta të kualifikimit të mësipërme përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me LPP dhe VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kriteret e hartuara janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Për secilin kriter janë përcaktuar dokumentet konkretë që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e atyre kriterëve.

SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

I. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i cili është ngritur me Urdher të Titullarit për llogaritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve të teknike në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

KLLFLST nuk ka paraqitur specifikime teknike për këtë objekt prokurimi.

Argumentim:Anëtarët pranuan procesverbalin dhe preventivin të hartuara nga Komisioni i posaçëm :**KLLFLST(Komisioni i llogaritjes të fondit limit dhe specifikimeve teknike)** i ngritur me urdhër të titullarit të Autoritetit Kontrakt **nr.6816prot,datë 29.08.2024, Preventivi është hartuar nga specialistet e fushës konkretisht nga KLLFLST ,dhe procesverbalin e komisionit nr.6816/1prot,datë 03.09.2024, dhe shprehin qarte kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e e kryerjes së shërbimit/mallrave.**

Preventivi I hartuara nga KLLFLST si mëposhtë për objektin:

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT\

OBJEKTI:"Shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit".

1 MJETI me targe AA478JE

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Riparim komplet i linjes se ajrit	sherbim	1
2	Riparim i sistemit te frenimit	sherbim	1
3	Riparim motorri	sherbim	1
4	Saldime ne shasi	sherbim	1
Shuma pa tvsh			
Tvsh 20%			
Shuma me tvsh			

2 MJETI me targe AA817OJ

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Riparim i sistemit te frenimit	sherbim	1
2	Riparim piston hidraulik	sherbim	1
3	Riparim sistemit te freksionit	sherbim	1
Shuma pa tvsh			
Tvsh 20%			
Shuma me tvsh			

3 MJETI me targe AA630 VN

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Riparim mekanizmi i kapjes se koshit	sherbim	1
2	Riparim i sistemit te frenimit	sherbim	1
3	F.V. Sofjeta freni	cope	2
4	Riparim i sistemit elektrike	sherbim	1
5	Riparim piston hidraulik	sherbim	3
Shuma pa tvsh			

4 MJETI Fadrom me targe ATMB 93

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Riparim i sistemit hidraulik	sherbim	1
2	Riparim piston hidraulik	sherbim	4
Shuma pa tvsh			

Tvsh 20%
Shuma me tvsh

5 MJETI me targe AB 032 HD

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Riparim i sistemit te frenimit	sherbim	1
2	Riparim i nofullave te frenimit	sherbim	2
3	F.V. Ferrota	cope	4
4	F.V. Xhundo transmisioni	cope	1
Shuma pa tvsh			
Tvsh 20%			
Shuma me tvsh			

6 MJETI me targe AB 587 IF

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	F.V. Filter vaji	cope	1
2	F.V. Filter ajri	cope	1
3	F.V. Filter nafte	cope	1
Shuma pa tvsh			
Tvsh 20%			
Shuma me tvsh			

7 MJETI me targe AA425UR

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Riparim i sistemit te hedhjes se ujit	sherbim	1
2	F.V. Sofjeta freni	cope	2
Shuma pa tvsh			
Tvsh 20%			
Shuma me tvsh			

MJETI me targe AA016FT

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	F.V. Filter vaji	cope	1
2	F.V. Filter ajri	cope	1
3	F.V. Filter nafte	cope	1
4	F.V. Kavogazi	cope	1

5	F.V. Kavo pistoni hidraulik	cope	1
6	Riparim i sistemit te frenimit	sherbim	1
Shuma pa tvsh			
Tvsh 20%			
Shuma me tvsh			

9 MJETI me targe AA183FA

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Riparim komplet i linjes se ajrit	sherbim	1
2	F.V. ferota	cope	4
3	F.V. Filter vaji	cope	1
4	F.V. Filter ajri	cope	1
5	F.V. Filter nafte	cope	1
6	Riparim i sistemit te frenimit	sherbim	1
Shuma pa tvsh			
Tvsh 20%			
Shuma me tvsh			

II. SHERBIM I ZJARRFIKSES

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Lyerje automjeti zjarrfikse me targa AA911TY	sherbim	1

Afatet e ekzekutimit:

Fillon nga data e nënshkrimit të kontratës deri në 31.12.2024, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.

Dokumentacioni pasi u firmos nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit, pasi u përpilua edhe formulari përmbledhës i njoftimit të kontratës, do të paraqitet titullarit të autoritetit kontraktor për tu firmosur dhe u ra dakort që të hidhen në formatin e sistemit elektronik nga personi përgjegjës i prokurimeve anëtar i NJ.P, për shpallje dhe botim nga APP.

NJËSIA E PROKURIMIT:

